VENDIM
Nr. 278, datë 25.9.2023

MBI MIRATIMIN E "KONTRATËS PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, KESH SHA DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË FURNIZOHEN NGA FSHU SHA PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2023–31.12.2023

Në zbatim të neneve 16, 20, germa "h", 47, 56, germa "f", si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 105, germa "c", të ligjit nr. 44/2015, "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë"; pjesës I, nenit 5, pika 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike", të ndryshuar me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 dhe me VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023; "Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 347, datë 27.12.2022; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1956/1 prot., datë 8.9.2023, "Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a." dhe informacionin shtesë me nr. 1957/3 prot., datë 22.9.2023, "Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a. dhe Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë FTL sh.a. për shitjen/blerjen/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike.",

konstatoi se:

- Shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1956 prot., datë 24.7.2023, dërguan në ERE kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve universalë për periudhën kohore 1.1.2023–31.12.23, mes shoqërisë KESH – FSHU me nr. 3165 prot., datë 26.6.2023 të KESH sh.a. dhe nr. 4924 prot., datë 26.6.2023 të FSHU sh.a.

- ERE, në zbatim të neneve 6 dhe 12, të "Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 162, datë 20.10.2020, me qëllim realizimin e procesit të konsultimit publik, më datë 25.7.2023, publikoi kontratën e sjellë për miratim në faqen zyrtare të internetit të saj për komente

apo objeksione dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Kontrata "Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve universalë për periudhën kohore 1.1.2023–31.12.23" përbëhet nga 22 nene, 2 shtojca (shtojca 1: programet e livrimit sipas neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate dhe shtojca 2: sipas nenit 19 "Pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të palëve për regjistrimet telefonike") dhe dy anekse (aneksi 1: "Parashikimi i konsumit të kërkuar nga ana e FSHU dhe aneksi 2: "Për rregullimet financiare të marrëdhënies së shitblerjes të energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. për periudhën kohore").

- Në titullin e aneksit 2 të kontratës së dakordësuar midis palëve nuk është vendosur një afat, vlerësohet se sikurse shpjeguar në nenin 1, pika 1.1, se ky aneks është shtuar për të rregulluar marrëdhënien financiare të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për energji për përmbushjen e detyrimit si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) për periudhën kohore 12.4.2023–31.12.2023, të plotësohet me këtë periudhë kohore edhe titulli i aneksit 2 "...për periudhën kohore 12.4.2023–31.12.2023", pasi sikurse jemi në dijeni, më datë 12.4.2023 filloi operimi i Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX sh.a.) e cila prej asaj date realizon operimin në tregun e ditës në avancë.

- Konstatohet se në kontratën e sjellë në ERE për miratim nuk referohen si bazë ligjore aktet e mëposhtme ligjore të cilat duhet të shtohen:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike", i ndryshuar me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 dhe me VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023;

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të ERE-s, "Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.", i ndryshuar;

- Vendimi nr. 215, datë 11.10.2018, i Bordit të ERE-s, "Mbi transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, date 8.7.2016, tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a., i ndryshuar;

- Vendimi nr. 164, datë 4.11.2019, i Bordit të ERE-s, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike";

· Gjithashtu në kontratën e sjellë për miratim në ERE janë shtuar këto akte ligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", i ndryshuar;

- Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 347, datë 27.12.2022, "Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (Rregullat e ALPEX, përkufizimet, procedurat e tregtimit dhe e klerimit dhe e shlyerjes)";

- Urdhri nr. 50, datë 7.4.2023, i ministrit përgjegjës për energjinë, "Për një ndryshim me urdhrin nr. 28, datë 18.1.2021, "Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike".

Lidhur me këto akte ligjore, duke marrë parasysh që Bursa Shqiptare e Energjisë është në fillesat e operimit të saj (data e fillimit të operimit 12.4.2023) dhe likuiditeti i saj duhet të maturohet, i

vlerësojmë të drejta parashtrimet e palëve për t' i shtuar në bazën ligjore të kontratës së sjellë për miratim në ERE.

- Shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., nëpërmjet shkresës së përbashkët protokolluar me tonën me nr. 1956 prot., datë 24.7.2023, me lëndë: "Dërgohet kontrata e lidhur ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për vitin 2023", kanë risjellë për miratim kontratën tip për rregullimin e marrëdhënies së "Shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal, FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve universalë për periudhën kohore 1.1.2023–31.12.2023".

ERE, me vendimin nr. 338, datë 21.12.2022, ka miratuar kontratën tip për rregullimin e marrëdhënies së "Shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve universalë për periudhën kohore dd/mm/vvvv-dd/mm/vvvv.", pra pa përcaktuar një periudhë kohore. Në zbatim të nenit 5, pikës 4, të VKM-së nr. 456/2022, dhe zgjatjes së periudhës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, vlerësohet e drejtë vendosja e periudhës kohore për përcaktimin e efekteve juridike të kontratës së sjellë për miratim në ERE me nr. 1956 prot., datë 24.7.2023, të cilat përfundojnë më 31 dhjetor 2023 dhe pas përfundimit të kësaj periudhe, mbetet në fuqi kontrata e miratuar nga ERE me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 338/2022.

- Neni 1 i kontratës së sjellë në ERE, nëpërmjet shkresës së përbashkët protokolluar me tonën me nr. 1956 prot., datë 24.7.2023, ndër të tjera, në pjesën e qëllimit i referohet periudhës kohore 1 janar –31 dhjetor", duke mos përcaktuar vitin respektiv.

Vlerësohet se bazuar në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e elektrike", i ndryshuar; VKM-në nr. 584/ 2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike", e ndryshuar me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 dhe me VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023, VKM-në nr. 519/2016, "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrikee ndryshuar, kur trajtohet periudha kohore 1 janar–31 dhjetor të shënohet dhe viti 2023, konkretisht: "Kjo kontratë (së bashku me shtojcat apo anekset e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për periudhën kohore 1 janar–31 dhjetor 2023".

- Për sa i përket përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike (neni 2 i kontratës), bazuar në përcaktimet e nenit 5, pikës 4, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, ky çmim miratohet nga Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë publike të prodhimit. Ky nen është riformuluar dhe vlerësohet se riformulimi i nenit 2 është i drejtë pasi përmban të gjithë komponentët e dakordësuar si sasia e kontraktuar e energjisë e destinuar për furnizim e shprehur sipas programeve mujore/javore/ditore/*day ahead*/*intra day* sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5, të kontratës së sjellë për miratim në ERE. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin 2023, i cili është miratuar sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. 10253/1 prot., datë 4.01.2023; si dhe energjinë për destinacion përdorimi furnizimin e Klientëve Universal të lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tensionit 6/10/20 kV, nën shërbimin e FMF-së, që do të tregtohet mes palëve nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë. Nga ana e shoqërive, në kontratën e sjellë për miratim në ERE, protokolluar me tonën me nr. 1956 prot., datë 24.7.2023, janë reflektuar të dhënat për referencë të (vendimi nr. 10253/1 prot., datë 4.1.2023), vendimit të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë së Prodhimit.

- Në nenin 4, të kontratës së sjellë për miratim në ERE, datë 24.7.2023, është shtuar pika 7, konkretisht: "Blerësi i dërgon shitësit të dhënat lidhur me furnizimin e energjisë për FMF-në sipas parashikimeve të aneksit II".

Në aneksin II, të kontratës së sjellë për miratim në ERE më datë 24.7.2023, palët kanë rënë dakord për sasinë e kontraktuar, vlerën e kompensimit dhe mënyrën e faturimit.

- Në nenin 5 të kontratës së sjellë për miratim në ERE më datë 24.7.2023, është shtuar pika 2, konkretisht: "Shitësi kompenson blerësin për çmimin e energjisë elektrike sipas parashikimeve të aneksit II të kësaj kontrate".

Në aneksin II, neni 2, pika 2.4, evidenton vlerën e kompensimit e cila do të rezultojë si diferencë e çmimit të shitjes në ALPEX dhe çmimit të rregulluar të shitjes, në bazë ditore, për sasitë e qarkulluara të energjisë mes palëve. Palët do të rakordojnë mes tyre sipas shtojcës nr. 1, pjesë e këtij aneksi (duhet të shkruhet pjesë e kësaj kontrate). Për sa rakorduar nga palët, ERE i vlerëson të drejta parashikimet në aneksin 2 sipas cilësimeve dhe në parashtrimet e kontratës.

- Ka ndryshuar neni 9 i kontratës së sjellë për miratim në ERE më datë 24.7.2023 dhe duke qenë se palët kanë përdorur si referencë sistemin NOVITA për nominimet që realizohen me qëllim furnizimin e klientëve të Shërbimit Universal, vlerësohet e nevojshme të zëvendësohet emërtimi i sistemit të nominimeve "NOVITA" me fjalët sistemin e përdorur nga OST sh.a. për realizimin e nominimeve. NOVITA është një sistem kompjuterik dhe nuk është subjekt i cili ka përgjegjësi ligjore. Vlerësohet që në nenin 9, pika 1, aty ku cilësohet sistemi NOVITA konkretisht "...energjia elektrike totale e nominuar në sistemin NOVITA..." të ndryshohet "...energjia elektrike totale e nominuar në sistemin për nominime të OST sh.a...".

Pasi përgjegjësitë ligjore i ka subjekti në rastin konkret OST sh.a. që operon me këtë sistem. Në këtë kuadër duhet të bëhen saktësimet përkatëse duke përdorur si referencë sistemin për nominime të OST sh.a.

- Ka ndryshuar neni 14 i kontratës së sjellë për miratim në ERE më datë 24.7.2023 dhe në këtë nen përdoret si referencë si më sipër sistemi i nominimeve NOVITA, vlerësojmë që të bëhen zëvendësimet përkatëse si në nenin 9 të kontratës, konkretisht në nenin 14, pika 1, aty ku cilësohet sistemi NOVITA "...Sasitë e energjisë e nominuar në sistemin NOVITA..." të ndryshohet "...Sasitë e energjisë të nominuara në sistemin për nominime të OST sh.a...". Ky nen vlerësohet të ndryshohet për sa shpjeguar dhe në nenin 9.

- Ka ndryshuar neni 21, pika 2 ishte: "2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate e cila hyn në fuqi pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë." dhe propozohet të bëhet: "2. Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate."

Vlerësojmë se ky nen nuk duhet ndryshuar pasi formulimi në kontratën e miratuar nga ERE me vendimin nr. 338/2022 shpreh më qartë detyrimin e palëve në zbatim të nenit 5, pikës 4, të VKM-së nr. 456/2022.

- Në aneksin nr. 1, te parashikimi i konsumit nga ana e FSHU vlerësohet të shtohet viti 2023 (si dhe tabela përkatëse).

- Në nenin 105, germa "c", të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" citohet se: c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë, duke argumentuar se kjo është një marrëdhënie dypalëshe ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., që duhet të rregullohet me kontratë në zbatim të nenit 5, pikës 4, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" dhe nuk dëmton palë të treta, vlerësohet që kontrata e sjellë për miratim në ERE me shkresën e protokolluar me tonën me 1956 prot., datë 24.7.2023 të miratohet nga ERE me ndryshimet e përcaktuara në konstatime për periudhën

1.1.2023–31.12.2023 dhe pas përfundimit të kësaj periudhe mbetet në fuqi kontrata e miratuar nga ERE me vendimin nr. 338/2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a për periudhën kohore 1 janar–31 dhjetor 2023 (bashkëlidhur).

2. Ndryshimet në titullin e kontratës, në bazën ligjore, në nenet 1, 9, pika 1, 14, pika 1, 21, pika 2 dhe emërtimet e aneksit nr. 1 dhe aneksit 2, si dhe pika 2.4, e aneksit 2, sipas konstatimeve në këtë vendim përfundojnë efektet juridike më 31 dhjetor 2023.

2.1 Në bazë ligjore të shtohen aktet e mëposhtme:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike", i ndryshuar me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022 dhe me VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023;

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të ERE-s, "Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.", i ndryshuar;

- Vendimi nr. 215, datë 11.10.2018, i Bordit të ERE-s, "Mbi transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të Shërbimit Universal të Furnizimit të Energjisë Elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE SH.A.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, date 8.7.2016, tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a., i ndryshuar;

- Vendimi nr. 164, datë 4.11.2019, i Bordit të ERE-s "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".

2.2 Neni 1 i kontratës ndryshon dhe bëhet: "Kjo kontratë (së bashku me shtojcat apo anekset e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet palëve për plotësimin e kërkesës së blerësit për periudhën kohore 1 janar–31 dhjetor 2023".

2.3 Neni 9, pika 1 ndryshon dhe bëhet: "Shitësi dhe blerësi, jo më vonë se data 10 e muajit, do të rakordojnë sasitë e energjisë elektrike që kanë shkuar për furnizimin e klientëve universalë, sasi e cila është energjia elektrike totale e nominuar në sistemin për nominime të OST sh.a dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë ALPEX".

2.4 Neni 14, pika 1, ndryshon dhe bëhet: "...Sasitë e energjisë të nominuara në sistemin për nominime të OST sh.a. do të faturohet me çmimin e përcaktuar për nivelin e tensionit 0.4 kV. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike.".

2.5 Neni 21, pika 2 ndryshon dhe bëhet: "Palët kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, lidhur me nënshkrimin e kësaj kontrate e cila hyn në fuqi pas miratimit nga Enti Rregullator i Energjisë.".

2.6 Emërtimi i aneksit 1 ndryshon dhe bëhet: "Parashikimi i konsumit të kërkuar nga ana e FSHU për vitin 2023.".

2.7 Emërtimi i tabelës bashkëlidhur aneksit 1 ndryshon dhe bëhet: "Me datë / / KESH sh.a. ka livruar/nonimuar në sistemin për nominime të OST sh.a. energjinë".

2.8 Në vijim të tabelës, në aneksin 1, togfjalëshi ndryshon dhe bëhet: "Sasia totale e energjisë e nominuar në sistemin e nominimeve të OST sh.a. dhe ALPEX".

2.9 Emërtimi i aneksit 2, ndryshon dhe bëhet: "...KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për periudhën kohore 1.1.2023–31.12.2023".

2.10 Neni 2, pika 4, e aneksit 2, ndryshon dhe bëhet: "Palët do të rakordojnë mes tyre sipas shtojcës nr. 1, pjesë e kësaj Kontrate.".

3. Me mbarimin e efekteve juridike të kontratës së miratuar me këtë vendim, palët do të zbatojnë kontratën tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 338, datë 21.12.2022, pa ndryshimet e miratuara në këtë vendim.

4. Kontrata e nënshkruar nga palët me ndryshimet sipas pikës 2 në këtë vendim, të dërgohet në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

5. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., FSHU sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti